



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 98/2017

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR DIASPORËN DHE
MIGRACIONIN”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR POLITIKËN E JASHTME**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Ngrihet nënkomisioni “Për diasporën dhe migracionin”, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme.
- II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë çështje të diasporës dhe fenomenit migrator të Shqipërisë.
- III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1.Adnor Shameti	Kryetar	(PS)
2.Tritan Shehu	Zëvendëskryetar	(PD)
3.Elona Hoxha	Anëtare	(PS)
4.Eglantina Gjermeni	Anëtare	(PS)
5.Klajda Gjoshja	Anëtare	(LSI)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 5.10.2017